



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
PËR
FORMËN, LLOGARITJEN DHE SHUMËN E KAPITALIT QË DUHET TË KETË
DETYRIMISHT SHOQËRIA ADMINISTRUESE E SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 25.06.2014

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 121, datë 24.08.2016

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i formës, llogaritjes dhe shumës së kapitalit që duhet të ketë detyrimisht dhe në çdo kohë shoqëria administrative e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me paragrafin 3, të nenit 12, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 3
Kapitali i shoqërisë administrative të SIK

1. Kapitali i shoqërisë administrative të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, në çdo kohë, duhet të jenë të paktën në shumën 15,625,000 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.

2. Nëse vlera neto e aseteve të administruara nga shoqëria administrative, tejkalon shumën prej 31,250,000,000 (tridhjetë e një miliardë e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, kapitali i shoqërisë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zmadhohet me 0.02 për qind të shtesës së vlerës neto të aseteve të administruara nga shoqëria administrative mbi kufirin e përmendur në këtë pikë.

3. Pavarësisht sa është parashikuar në këtë nen, kapitali i shoqërisë administruese nuk duhet të jetë më pak se 1/4 e shpenzimeve operative fikse të shoqërisë administruese të llogaritura, bazuar në pasqyrat vjetore financiare të vitit paraardhës.

4. Kapitali i shoqërisë administruese llogaritet si diferencë e asetëve dhe detyrimeve të pasqyrës financiare të shoqërisë.

5. Kapitali i shoqërisë administruese, në çdo kohë, duhet të jetë më i madh ose i barabartë me shumën më të madhe ndërmjet:

- a. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
- b. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Nëse shoqëria administruese fillon veprimtarinë gjatë vitit kalendarik, kapitali i shoqërisë duhet të jetë sa shuma më e madhe ndërmjet:

- a. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
- b. Vlerës së 1/4 të shpenzimeve operative fikse të shoqërisë administruese të parashikuar në planin e biznesit, nëse nuk është kërkuar ndonjë ndryshim nga Autoriteti.

7. Shoqëria administruese njofton menjëherë Autoritetin, nëse kapitali bie nën nivelin e kërkuar në këtë rregullore.

Neni 4 **Shpenzimet operative fikse**

1. Shpenzime operative fikse konsiderohen shpenzimet që janë të pavarura nga asetet e administruara dhe rezultati i shoqërisë administruese, të tilla si:

- a. Shpenzimet për personelin;
- b. Shpenzime të tjera operative fikse;
- c. Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata;
- d. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe;
- e. Rregullimi i vlerës së aktiveve afatshkurtra.

2. Në zbatim të këtij neni, pjesa e shpenzimeve të personelit që varen ekskluzivisht nga rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe që parashikohen ligjërisht (nëpërmjet kontratës) janë të zbritshme nga shkronja a) pika 1 e këtij neni.

3. Shpenzimet e jashtëzakonshme nuk konsiderohen shpenzime operative fikse sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 5* Forma e kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë administruese duhet të mbahet në llogari rrjedhëse, depozita bankare, instrumente financiare lehtësisht të kthyeshme në para dhe nuk duhet të investohet në instrumente financiarë spekulativë (instrumentë që mbartin një nivel të lartë të riskut të humbjes).

Neni 6 Vlera neto e aseteve të administruara nga shoqëria administruese

1. Shoqëria administruese për efekt të llogaritjes së vlerës neto të aseteve të përmendura në paragrafin 2 të nenit 3, të kësaj rregulloreje, merr në konsideratë:
 - a) Vlerën neto të aseteve të secilit prej fondeve të investimeve nën administrimin e shoqërisë administruese duke përfshirë asetet, për të cilat është deleguar funksioni administrues por duke përjashtuar asetet që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër;
 - b) Vlerën neto të aseteve të secilës prej shoqërive të investimit, portofoli i të cilave, administrohet nga shoqëria administruese;
 - c) Vlerën neto të aseteve të fondeve të pensionit vullnetar nën administrimin e shoqërisë administruese duke përfshirë asetet, për të cilat është deleguar funksioni administrues, por duke përjashtuar asetet që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër.

Neni 7 Shkeljet

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje përbën shkelje dhe shoqëria administruese do të jetë subjekt i masave të parashikuara në nenin 130, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 2014.

3. Pavarësisht sa është parashikuar në këtë nen, kapitali i shoqërisë administruese nuk duhet të jetë më pak se 1/4 e shpenzimeve operative fikse të shoqërisë administruese të llogaritura, bazuar në pasqyrat vjetore financiare të vitit paraardhës.

4. Kapitali i shoqërisë administruese llogaritet si diferencë e aseteve dhe detyrimeve të pasqyrës financiare të shoqërisë.

5. Kapitali i shoqërisë administruese, në çdo kohë, duhet të jetë më i madh ose i barabartë me shumën më të madhe ndërmjet:

- a. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
- b. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Nëse shoqëria administruese fillon veprimtarinë gjatë vitit kalendarik, kapitali i shoqërisë duhet të jetë sa shuma më e madhe ndërmjet:

- a. Vlerës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
- b. Vlerës së 1/4 të shpenzimeve operative fikse të shoqërisë administruese të parashikuar në planin e biznesit, nëse nuk është kërkuar ndonjë ndryshim nga Autoriteti.

7. Shoqëria administruese njofton menjëherë Autoritetin, nëse kapitali bie nën nivelin e kërkuar në këtë rregullore.

Neni 4 **Shpenzimet operative fikse**

1. Shpenzime operative fikse konsiderohen shpenzimet që janë të pavarura nga asetet e administruara dhe rezultati i shoqërisë administruese, të tilla si:

- a. Shpenzimet për personelin;
- b. Shpenzime të tjera operative fikse;
- c. Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata;
- d. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe;
- e. Rregullimi i vlerës së aktiveve afatshkurtra.

2. Në zbatim të këtij neni, pjesa e shpenzimeve të personelit që varen ekskluzivisht nga rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe që parashikohen ligjërisht (nëpërmjet kontratës) janë të zbritshme nga shkronja a) pika 1 e këtij neni.

3. Shpenzimet e jashtëzakonshme nuk konsiderohen shpenzime operative fikse sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 5*
Forma e kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë administruese duhet të mbahet në llogari rrjedhëse, depozita bankare, instrumente financiare lehtësisht të kthyeshme në para dhe nuk duhet të investohet në instrumente financiarë spekulativë (instrumentë që mbartin një nivel të lartë të riskut të humbjes).

Neni 6
Vlera neto e aseteve të administruara nga shoqëria administruese

1. Shoqëria administruese për efekt të llogaritjes së vlerës neto të aseteve të përmendura në paragrafin 2 të nenit 3, të kësaj rregulloreje, merr në konsideratë:
 - a) Vlerën neto të aseteve të secilit prej fondeve të investimeve nën administrimin e shoqërisë administruese duke përfshirë asetet, për të cilat është deleguar funksioni administrues por duke përjashtuar asetet që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër;
 - b) Vlerën neto të aseteve të secilës prej shoqërive të investimit, portofoli i të cilave, administrohet nga shoqëria administruese;
 - c) Vlerën neto të aseteve të fondeve të pensionit vullnetar nën administrimin e shoqërisë administruese duke përfshirë asetet, për të cilat është deleguar funksioni administrues, por duke përjashtuar asetet që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër.

Neni 7
Shkeljet

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje përbën shkelje dhe shoqëria administruese do të jetë subjekt i masave të parashikuara në nenin 130, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 2014.